

KONTRATE THËMLIMI  
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"ILIRIA" SH.P.K.



Personat qe firmosin me poshtë:

Z.Skender Omeri, i datelindjes 1959, i biri i Qemalit, lindur dhe banues ne Delvine; me shtetesi shqiptare.

Z.Fuat Omeri, i datelindjes 1953, i biri i Qemalit, lindur dhe banues ne Delvine, me shtetesi shqiptare;

kane hartuar si më poshtë vijon kontraten e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te cilen jane marr vesh te themelojne midis tyre.

Shoqeria vepron ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi si dhe te dispozitave te statutit qe i bashkangjitet ketij akti.

Emertimi i shoqerise eshte "ILIRIA" SH.P.K.

Objekti i shoqerise eshte:

-Projektim dhe venie ne zbatim te projekteve te ndryshme.

-Punime te ndryshme dheu,murature,betonarme,punime shembjesh,rikonstruksion,ndertime civile,industriale,turistike,kompletimi me instalime te nevojshme elektrike dhe hidròsanitare,ndertim ujesjeksash,rruge,dige,galeri,tunele, ndertime bujqesore,kanalizime.


Selia e shoqerise ndodhet ne Lagjen "9 Tettori" Delvinë.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë. Ky kapital perbehet nga kontributet e me poshtme:

Z.Skender Omeri kontribon ne shumen 76.000 lekë.

Z.Fuat Omeri kontribon ne shumen 24.000 lekë.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese, plotesisht te shlye shme, me vlore 1000 leke sejcilia,terenditura sipas marrit te serise



nga 1 deri ne 100.

Ne bazë te kontributeve te lartepermendura:

Z.Skdner Omeri mer 76 pjesë te kapitalit themeltar, te renditura nga numri i serise 1 deri ne numrin e serise 76, per kontributin e tij ne para.

Z.Fuat Omeri mer 24 pjesë te kapitalit themeltar; te renditura nga numri i serise 77 deri ne numrin e serise 100, per kontributin e tij ne para.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar janë nenshkruar, shlyer plotës shtë dhe janë shperndare ndërmjet ortakeve si me lartë.

Sejcili prej ortakeve ka derdhur tek z.Skender Omeri shumen koresponduese te pjeseve te nenshkruara. Shumat e **mbledhura** janë depozituar projtij ne Degen e Bankes se Shitetit Sarahde ne një llogari te hapur ne eme te shoqerise.

Personat qe firmosin ne kete kontrate, pasi kane mare dijeni per derdjen e fondeve, deklarojne se shumat e derdhura prej tyre janë ne perputhje me ate qe shenohet ne çertifikaten e dhene nga Banka dhe se ata konfirmojnë nenshkrimet e pjeseve te kapitalit themeltar ne perputhje me shumat e derdhura respektivisht.

Shoqeria do te administrohet nga një administrator i vetem. Administrator i emeruar eshte z.Skender Omeri, me një mandat 3 vjeçar dhe me të drejtë rrizgjedhje.

Z.Skender Omeri i jepen te gjitha kopetencat, te cilat ai i pranon per te kryer te gjitha formalitetet e thomelimit te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Kjo, kontrate themeluese eshte hartuar ne Sarande më 20.06.1994 ne kater ekzemplare, ne gjuhen shqipe duke pasur te gjitha fuqi te barabartligjore.

SKENDER OMERI

FUAT OMERI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DRJTESËSSE

NOTERIA DREVINË

Nr. 673 Rep.  
Nr. 49Y Kol.

#### V E R T E T I M

Sot me daten 20.06.1994, para meje noteres Ermioni Gjoka u paraciten personamisht z.Skender Omeri dhe z.Fuat Omeri, madhore, me zotesi te plotë per te vepruar (juridike), per identitetin e te cileve u binda nga leteri njoftimet e tyre personale, te cilet me deklaruan se sa me siper eshte shkruar sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plotë, mençnjatine rregullat



## S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"ILIRIA" SH.P.K.

Personat qe firmosin me poshte:

Z.Skender Omeri, i biri i Qemalit, i datelindjes 1959, lindur dhe banues ne Lagjen "9 Tetori" Delvine, me shtetesi shqiptare.

Z.Fuat Omeri, i biri i Qemalit, i datelindjes 1953, lindur dhe banu ne Lagjen "9 Te tori" Delvine, me shtetesi shqiptare;

kane hartuar si më poshte vijon,kontraten e themelimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, te cilen jane mare vesh ta themelojne midi tyre.

### KREU I

FORMA,EMERTIMI I SHOQERISE,OBJEKTI,SELIA,KOHEZGJATJA.

### Neni 1

FORMA

Ndermjet firmuesve te aktit themeltar eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me dispozitat e ketij statuti.

### Neni 2

Emri i shoqerise eshte "ILIRIA" SH.P.K.

### Neni 3

Objekti i shoqerise

-Projektim dhe venie ne zbatim te projekteve te ndryshme.

-Punime te ndryshme dhei,murature,betonarme,punime shembjesh,rokons uksione, ndertime civile,industriale,turistike,kompletimet me instalime te nevojshme elektrike dhe hidro-sanitare,ndertim ujeshjelleash,rruge,dige,galeri,tunele,punime bujqesore,kanalizime.



Neni 4.

Selia e shqerise

Selia e shqerise eshte ne Lagjen "9 Tetori" ne Delvinc.

Transferimi i selsise se shqerise ne nje adresë tjeter behet me mirtim te ortakut qe zoteron mbi 3/4 e pjesave te kapitalit themeltar.

Neni 5.

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shqerise eshte percaktuar per nje periudhe prej 15 vjetesh duke filluar nga adata e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar.Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ose te shkurtohet kur shqeria prishet para kohe.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR,KONTRIBUTET,PJESET E KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar eshte 100.000 leke.

Ai eshte i ndare ne 100 pjesa me vlore 1000 leke sejcila, te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100, te shlyera plotesisht.

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjesave te reja,ortaket kane te drejten e perparese ne nenshkrim,propocionalite me shumen e pjesave te tyre.

Shqeria mund ta zvogeloje kapitalin e saj.Zvogelimi i kapitalit veroset nga asambleja e ortakeve me prezencen e vet ortakeve dhe me pelqi e ortakut qe zoteron me shume se 3/4 e kapitalit themeltar.Zvogelimi i kapitalit i prek te dy ortaket ne te njejten mase.

Neni 7

Pjeset e kapitalit themeltar

Z.Skender Omeri mer pjesa ne 76 pjesa te kapitalit themeltar, te renditura nga numri i serise 1 deri ne numrin e serise 76, per kontributin e tij ne para.

Z.Fuat Omeri mer 24 pjesa te kapitalit themeltar te renditura nga numri i serise 77 deri ne numrin e serise 100 per kontributin e tij ne para.

Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin themeltar ne plotesishte e shperndehen ndermjet ortakeve simpas ndarje se kontributet



Neni 8

Kontributet

Z.Skender Omeri kontribon ne shumen prej 76.000 leke.

Z.Fuat Omeri kontribon ne shumen prej 24.000 lekë.

Neni 9

Lenia dhe trasferimi i pjeseve te kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te trasferueshme ndermjet ortakove, ne rruge trashegimie, ne rast nuarje pasurore ndermjet bashkesoreve dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund te trasferohen te treteve vetem me miratim te ortakut qe zoteron mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar dhe me kushte jom me te favorshme se ato me te cilat ju jane afruar me pare ortakut tjeter.

KREU III

ORTAKET, ASAMBLEJA E ORTAKEVE, ADMINISTRIMI, EKSPERTET KONTABEL

Neni 10.

Ortaket dhe asambleja e ortakeve

Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vlerave se kontributat te tyre ne kapitalin themeltar. Qdo ortak ka te drejte te bëte me pjesa ne mbledhjet e e asamblese dhe disponon nje numur votash te bërabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe zoteron. Ne ushtrimin e se është se tyre per te mare pjesa ne vendimet kolektive, qdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje ortak tjeter ose nga nje person tjeter i zgjedhur prej tij.

Mbledhja e asamblese mund te thirret nga sejciili ortak, nga administratori, nga ekspertet kontabel te autorizuar ose nga likujduesit.

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e asamblese mund te jetë e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asambleja e zakonshme vendos per çeshtje tilla si emerimi dhe shkarkimi i administratorave, ekspertave kontabel te autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve te administrimit, kontrollit, miratimit te llogarive vjetore dhe ndarjes se fitimit.

Asambleja e jashtezakonshme vendos per çeshtje tilla si per ndryshimet e statutit, zvogelimi i kapitalit themeltar, trasferimi i pjeseve te

kapitalit themeltar, trasferimi i pjesave te kapitalit te tjeret, zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise apo shnderimi i saj shnderimi i shoqerise ne shoqeri te formave te tjera, ete

Asambleja e zakonshme ne mbledhjen e pare te saj mer vendime te vlefshmene rast se jane prezent te dy ortaket ose te perfaqesuar. Kjo vlen edhe per asamblene e jashtezakonshme. Ne rast se mbledhja e pare nuk realizohet atehere ortaku qe ka me shume se 3/4 e kapitalit themeltar mund vendose dhe vendimet e tij Jane te detyrueshme dhe per ortakun tjeter.

Neni 11

Administrimi

Shoqeria administrohet nga nje administrator qe duhet te jetet person fizik dhe mund te jetet ortak ne shoqeri ose jo. Administratori mund te erohet dhe te shkarkohet me miratimin e te dy ortakeve ose ne rast se ka kundershtimevendos ortaku qe ka me shume se 3/4 e kapitalit themeltar, pra me shume se 3/4 pjese. Emerimi i tij behet per nje kohezgjatje prej 3 vjetesh financiar me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem.

Ne marhenie ne ortaket qe te tretet, administratori ka te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet akteve qe jane ne perputhje me obektin e shoqerise, me perjashtim te atyre kopetencave qe ligji dhe ky statut ja jepin shprehimisht ortakeve.

Administratori eshte perpjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij. Administratori ka te drejte te delegojet nje pjese te kopetencave te tij nje ortaku tjeter me ane te nje akti me shkrim.

Neni 12

Eksperet kontabel te autorizuar

Kontrolli i shoqerise kryhet nga njc ekspert kontabel i autorizuar qe eshte i emeruar per tre vite financiar me mundesi rrizgjedhje nga ortake ose nga ortaku qe ka mbi 3/4 e pjesave te kapitalit themeltar. Shkarkimi eksperit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emri ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE



Neni 13

Viti finanziar, llogarite vjetore

Çdo vit finanziar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Perjashtimisht viti i pare finanziar do te perfundoje me 31 dhjetor 1994.

Llogarite vjetore, inventari, reportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e vëçanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga asambleja dhe me vendim te ortakeve. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behen brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit finanziar.

Neni 14

Dividentet

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, asambleja e ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividenteve mbi fitimin. Fitimi do te ndahet ndermjet ortakeve, ne formen e dividenteve, ne propocion me pjeset e kapitalit themeltar, qe pertehet nga fitimi i vitit finanziar, te cilit i jane zbritur shumat e lene menjeane per fodnin rezevre te domozdoshem (5% e fitimit te çdo vitit derisa ky fond te arrije vleren 1/10 te kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetra i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbetur nga vitet e meparshme.

KREU V

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 15

Me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 5 te ketij statuti zgjedhja e tij mund te vendoset nga asambleja me miratim te ortakeve qe zotero mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 16

Prishja

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 5 te

ketij statuti, me perjashtim te rasteve kur behet zgjatje e afatit sipas  
nenit 15 ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsjet e parashikuara  
ne ligj.

Shoqeria nuk prishet kur njeri prej ortakeve falimenton, behet i pa  
afte ose vdes.

Neni 17

Likujdimi

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne moventin e prishjes se  
saj. Per kryerjne e ketij procesi asambleja emeron nje ose disa likujdato  
te cilet paraqsin para asamblese raportin mbi gjendjen e aktivit dhe te  
pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te shoqerise ( te likuj  
dimit) dhe mbi afatin e nevojshem te likujdimit (te perfundimit) te tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit asambleja vendos me miratim te ort  
akeve mbi bilancin perfundimtar finanziar, mbi aktin e rregullishmerise se  
punes se likujduesit dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

Pas pagimit te **krediterreve** dhe shlyerjes se pjesave te kapitalit  
themeltar tek kontribucisit perkates, likujduesi ndan kapitalet e mbetura  
ndermjet ortakeve propocionalisht me pjeset qe zoterojne ata ne kapitali  
themeltar.

KRLU VI

DISPOZITA TE FUNDET

Neni 18

Shndrimi i shoqerise

Shndrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive  
ose ne shoqeri komandite mund te kryhet vetem me miratim te dy ortakeve

Neni 19

Mosmareveshjet

Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se sho  
ri se ose gjate periudhes se likujdimit ndermjet ortakeve do ti paraqite  
per zgjidhje gjykatave kopetene shqiptare.

Neni 20

Ky statut eshte hartuar ne daten 20.06.1994 ne Sarande ne 4(kater) kopje origjinal ne gjuhen shqipe duke patur te gjitha tekset te njejtene fuqi ligjore.

SKENDER OMERI

FUAT OMERI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISI  
NOTERIA DELVINE

Nr. 673 Rep.  
Nr. 495 Kol.

V E R T E T I M

Sot me daten 20.06.1994, para meje noteres Ermioni Gjoka u paraqiten personalisht z.Skender Omeri dhe z.Fuat Omeri me zotesi te plete per te vepruar(juridike), per identitetin e te cileve u binda nga leternjoftime e tyre personale,te cilat me deklaruan se sa me siper eshte shkruar sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plete,nenshkruejne rregullisht para meje dhc une noterja e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E



/ ERMIIONI GJOKA /